SET OF NUMBERED MULTILINGUAL SCHOOL NOTICES
ALBANIAN

LIST OF NOTICES IN ENGLISH

| | |
|---|---|
| Notice No 1 | **Information regarding parent participation** |
| Notice No 2 | **Participation in Parent/Teacher interview** |
| Notice No 3 | **Special Event/ Meeting/Function** |
| Notice No 4 | **Prep intake** |
| Notice No 5 | **Student Excursion Consent Form (for excursions not requiring school council approval)** |
| Notice No 6 | **End of term** |
| Notice No 7 | **No school** |
| Notice No 8 | **Collection of EMA** |
| Notice No 9 | **Travel card** |
| Notice No 10 | **Transition** |
| Notice No 11 | **Exit from English Language School or Centre** |
| Notice No 12 | **Medical-condition** |
| Notice No 13 | **Immunisation records** |
| Notice No 14 | **Fees and levies** |
| Notice No 15 | **Student absence** |
| Notice No 16 | **Swimming Program** |
| Notice No 17 | **Meeting Request** |
| Notice No 18 | **List of items required for an excursion** |

(School letterhead/logo)

(Date/Data )

Të dashur Prindër dhe Kujdestarë,

Me shkollën e fëmijës suaj mund të lidheni në disa mënyra. Shkolla do t'ju japë informacione se si t'a ndihmoni atë dhe se si të merrni pjesë në edukimin e fëmijës suaj. Gjithashtu ajo ju fton që të merrin pjesë në aspekte të ndryshme të programeve të saj.

Gjatë vitit do të ftoheni që të merrin pjesë në takime, evenimente dhe mbrëmje të organizuara nga shkolla. Disa takime mbahen për të dhënë informacione në lidhje me programin  mësimor kurse të tjerë kanë për qëllim t'ju informojnë në lidhje me përparimin e fëmijës suaj.

Në aktivitetet e shkollës mund të merrni pjesë edhe duke u zgjedhur si anëtar i Këshillit të Shkollës, ose si anëtar i ndonjë grupi organizativ ose duke ndihmuar në përgjithësi në organizimin e aktiviteteve të shkollës.

**Nëse dëshironi më shumë informacion në lidhje me Klubet e Prindërve ose Këshillin e Shkollës, ju lutemi që të kontaktoni shkollën.**

Nëse dëshironi që të bisedoni në lidhje me fëmijën tuaj apo shkollën, ju lutemi që të kontaktoni mësuesin e fëmijës suaj, drejtorin e shkollës ose anëtarë të tjerë të personelit.

Nënshkrimi………………………

Data…………………………

(School letterhead/logo)

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

Në ……………………………………………ju ftojmë që të vini në shkollë për t'u takuar me
(date/data)
……………………………………………………………………………………………….(name of teacher/s/ emri i mësuesit/ve)
për të diskutuar në lidhje me përparimin e fëmijës suaj dhe për programet që ka përgatitur shkolla për të. Ky takim quhet takim me prindër. Qëllimi është që të keni mundësi që të diskutoni çështjet që ju shqetësojnë, të jepni informacione ose të bëni pyetje në lidhje me edukimin shkollor të fëmijës suaj. Edukimi varet nga bashkëpunimi mes prindërve, mësuesve dhe nxënësve prandaj interesi dhe pjesëmarrja juaj në këto takime ka shumë rëndësi.

Ju mirëpresim në takim.

Nënshkrimi ......................................
Data.................................................

-------------------------------- ---------------------------------------X

Ju lutemi PLOTËSOJENI, PREJENI DHE KTHEJENI këtë pjesë të formularit përpara datës
.............................................................................................................................................
(date/data)

Emri i Prindit/Kujdestarit…………………………………………………………………...
Emri i Nxënësit:........................................................... Klasa: ................................................

Ju lutemi shënoni orarin më të përshtatshëm për takim me prindër duke shënuar kutinë e posaçme.

☐........................................................... ☐ ................................................
☐........................................................... ☐ ................................................
☐........................................................... ☐ ................................................
☐........................................................... ☐ ................................................

Kam nevojë për përkthyes në gjuhën.........................................................
(language/Gjuha)

Nënshkrimi.........................................................................................................................................
(Parent/Guardian/Prindi/Kujdestari)
Data ....................................................

(School letterhead/logo)

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

Jeni të ftuar të merrni pjesë në një eveniment të organizuar nga shkolla. Këtu do të keni mundësinë që të njiheni më nga afër me shkollën, të takoni mësuesit dhe prindërit e tjerë.

❒ mbrëmje informative për prindërit/kujdestarët e nxënësve të klasës ________________

❒ sesion informativ në lidhje me kampin e shkollës______________________________

❒ mbrëmje me rastin e fundit të gjysëm-semestrit/vitit

❒ karnavalet e notit/sportit

❒ mëngjes me çaj për prindër/kujdestarë

❒ eveniment i veçantë me rastin e __________________________

❒ të tjera __________________________________

Ky eveniment do të mbahet në____________________________________________________________________

në ______________________në ____________.

❒ do të ketë përkthyes ❒ nuk do të ketë përkthyes

Shpresojmë se keni mundësi që të merrin pjesë dhe ju mirëpresim.

Nënshkrimi……………………………..

Data………………………………..

---

Ju lutemi PLOTËSOJENI, PREJENI DHE KTHEJENI këtë pjesë të formularit përpara datës ………… (Date/Datës)

Unë ………………….. kam /nuk kam mundësi që të marr pjesë. Emri fëmijës tim është ………………………

Kam nevojë për përkthyes **nëse është e mundur** ❒

Kam nevojë për përkthyes në gjuhën ………………………………

Nënshkrimi ................................................ Data ...................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Prindër/Kujdestarë,

Ndihemi të kënaqur që ……………………………………… (student's name/emri i nxënësit) do të jetë në shkollën tonë vitin që vjen. Ju ftojmë që të vini në shkollë përpara fillimit të shkollës për tu takuar dhe njohur me mësuesin/mësuesit e fëmijës suaj. Jemi të gatshëm që të bisedojmë me ju në lidhje me fëmijën tuaj, me aktivitetet e shkollës si edhe me mënyrat e bashkëpunimit mes jush dhe personelit të shkollës në mënyrë që fillimi i shkollës të jetë një fillim i mbarë për fëmijën tuaj.

Ju lutemi që të vini në shkollë në …………………………….(time/orën)

në…………………………………………(date/datën)

Ju lutemi merreni fëmijën me vete. I mirëpresim edhe anëtarët e tjerë të familjes.

Ju lutemi që të vini në shkollë në …………………………….(time/orën)

në…………………………………………(date/datën)

Ju lutemi merreni fëmijën me vete. I mirëpresim edhe fëmijët e tjerë.

Nënshkrimi...................................................

Data........................................................

---

Ju lutemi PLOTËSOJENI, PREJENI DHE KTHEJENI këtë pjesë të formularit përpara datës ………… (Date/Datës)

Emri i Prindit/Kujdestarit:..................................................

Emri i Nxënësit: ..........................................................................

Unë ☐ kam / ☐ nuk kam mundësi që të vij në shkollë në .........................në........................
(date/datën) (Time/ orën)

Kam nevojë për përkthyes në gjuhën ………………………………

Nënshkrimi ................................................ Data ...................................................

**(vetëm për ekskursione që nuk kanë nevojë për miratimin e Këshillit të Shkollës)**

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

**Emri i Ekskursionit:**

**Destinacioni i Ekskursionit:**

**Data (t) e ekskursionit:**

**Orari i nisjes dhe i mbërritjes**:

**Nxënësit do të udhëtojnë me**: ☐autobuz ☐tren ☐ tramvaj ☐në këmbë

**Personeli dhe Kujdestarët**:

**Kosto:**

**Dreka**:
- ☐ Nxënësit duhet të marrin me vete drekën dhe pije në kuti prej materiali të pathyeshëm.
- ☐ Dreka mund të blihet gjatë ekskursionit $.....
- ☐ Kostoja e drekës është futur tek kostoja e ekskursionit.

**Veshjet dhe mjetet e nevojshme:**

**Emri dhe të dhënat e kontaktit për personin që duhet kontaktur në rast urgjence gjatë ekskursionit:**

**Të tjera**:

**Nëse keni pyetje apo shqetësime, ju lutemi kontaktoni ………………………….……….……….……**

**në …………………..…….** (phone number/numri i telefonit).

## Leja e Prindit:

Jap leje që vajza/djali im (full name/Emri dhe Mbiemri)

Të marrë pjesë.

Prindi/Kujdestari (full name/ Emri dhe Mbiemri)

(signature/Nënshkrimi)

(date/data)

In case of emergency I can be contacted on:
Në rast urgjence mund të kontaktohem në:

_____________________ OR/OSE:
Phone/Telefoni

____________________________
Phone/Telefoni

**Medical consent / Leja mjekësore**
Kur mësuesi kryesor nuk është në gjendje që të më kontaktojë ose nuk ka mundësi që të më kontaktojë, e autorizoj që:

- Të japë leje që fëmija im të marrë ndihmë mjeksore apo kirurgjikale sipas vendimit të një mjeku.
- Të japë ndihmën e parë nëse lind nevoja.

Nënshkrimi i Prindit/Kujdestarit:

Data:

(School letterhead/logo)

(Date/Data

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

Shkolla nis në .......................................................................................................................
(day/ditën) (date/datën)

në ....................................për këtë gjysëm-semestër/pushimet e fundvitit.
(time/koha)

Shkolla do të rifillojë ..........................................................................................në.................... .
(day/dita) (date/data) (time/ora)

Nënshkrimi …………………………………

Data.............................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data )

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

..............................................................................................................................................nuk do të ketë shkollë.
(day/dita) (date/data)

Ju lutemi që të mos e sillni në shkollë fëmijën në këtë datë.

Shkaku:

- Ditë jo-mësimore (Dita e Programit Mësimor) ❑
- Festë Zyrtare ❑
- Të tjera ❑

Nënshkrimi…………………………………….

Data ………………………………………

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Shkolla ka marrë çekun me këstin e parë/të dytë të “Education Maintenance Allowance” (Pagesa për Shpenzimet e Shollës). Ju lutemi që të paraqiteni në shkollë për ta marrë dhë për të nënshkruar fletë-dorëzimin. Merreni këtë letër me vete.

Data .....................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të dashur Prindër/Kujdestarë,

Kartat e konçesioneve për biletat e transportit u japin mundësi nxënësve që të udhëtojnë me transportin publik duke paguar një tarifë më të ulët.

Ata nxënës që janë të regjistruar në shkollë kanë të drejtë që të marrin karta konçesioni. Për të marrë Student Travel Concession Card (Kartë Studentore Konçesioni për Udhëtime) prindërit duhet të plotësojnë një formular i cili mund të merret në shkollë ose nëpër stacionet e trenave. Së bashku me të duhet të futen edhe dy fotografi pasaporte me ngjyra të nxënësit dhe pasi të vulosen nga shkolla të gjitha bashkë duhet të dorëzohen në një nga stacionet e trenave.

**Kartat e Konçesioneve mund të përdoren shtatë ditë në javë. Mos harroni që sipas ligjit nxënësit duhet të mbajnë me vete "Victorian Public Transport (VPT) Student Travel Concession Card" (Kartë Studentore Konçesioni për Udhëtime nga Transporti Publik i Viktorias) sa herë që udhëtojnë me biletë të blerë me konçension. Nëse kjo kartë nuk paraqitet kur i kërkohet, nxënësi mund të gjobitet.**

Nëse nxënësit e humbin kartën, atyre i duhet që të paguajnë $ ........... për ta zëvendësuar.

Nënshkrimi .....................................................

Data ........................................................

**Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me transportin publik, METLINK ofron linjë informacioni me përkthyes.**

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Më kanë informuar se fëmija juaj .........................................................................
(Name/Emri)

do të jetë në Vitin e 7-të vitin që vjen në:

(School/Shkollën)……………………………………………………………………………..

(Address/Adresa) ………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………..
……………………………………………………………………………………………..
………………………………………………………………………………………………
Telefoni: ..........................................................................................................

Nëse dëshironi të diskutoni më tej në lidhje me shkollën, regjistrimet apo uniformën, ju mund të kontaktoni ...................................................................................................................në.....................................
(name of contact person and position/emri i personit dhe pozita) (phone/telefoni)

Nënshkrimi ............................................

Data.......................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Fëmija juaj, ............................................................................, sapo mbaroi Kursin e Mësimit të Gjuhës
(Name/Emri)

Angleze dhe tani është gati që të mësojë në shkollën normale. Ai/Ajo do të shkojë në:

SHKOLLA: ..........................................................................................

ADRESA: ..........................................................................................
..........................................................................................

PERSONI PËR KONTAKTE: ....................................................

TELEFONI:.........................................................................................

Nëse keni ndonjë pyetje, ju mund të kontaktoni Shkollën/Qendrën e Mësimit të Gjuhës:

......................................................................................në..........................................................

(Contact person/Personi për Kontakte) (Phone/Telefoni)

Nënshkrimi ............................................

Data.......................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Nëse fëmija juaj vuan nga një sëmundje kronike (për shembull azëm, epilepsy, alergji, diabet, talasemi, hemofili ose sëmundje zemre) e cila ndikon tek ai/ajo gjatë kohës që ai/ajo është në shkollë, ju duhet t'a informoni shkollën. Të gjitha informacionet mbahen të fshehta.

Të gjitha mjekimet që duhet të merren në shkollë duhet të etiketohen me emrin e fëmijës, dozën dhe orarin e marrjes.

Mjekimet duhet t'i jepen mësuesit të klasës, përveç atyre rasteve kur me mësuesin është kryer një marrëveshje tjetër, (për shembull mjekimet për azmën zakonisht i mban vetë fëmija).

Mjekimet për heqjen e dhimbjeve mund të jepen vetëm me lejen e prindërve/kujdestarëve.

Nëse dëshironi që të bisedoni më gjerë në lidhje me gjendjen shëndetësore të fëmijës suaj ju lutemi që të telefononi tek........................................................................................................... ……………
(name/emri)
në......................................për të caktuar një takim.
(phone/telefoni)

Nënshkrimi .................................................

Data ……………………………………

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Kur një fëmijë regjistrohet për herë të parë në një shkollë në Viktoria, atij ose asaj i duhet të dorëzojë çertifikatën e vaksinimeve.

**Kjo çertifikatë përmban vaksinat e difterisë, tetanozit, poliomelitit, lisë, fruthit, rubeolës, kollës së more dhe gripit hemofilik tipi B.**

Çertifikatën duhet t'a dorëzojnë edhe ata nxënës që transferohen nga një shkollë në tjetrën. Këto çertifikata mund të merren nga komunat apo bashkitë lokale, nga qendrat e shëndetit të nënave dhe fëmijëve si edhe nga mjekët e familjes.

**Ata nxënës që nuk janë të vaksinuar lejohen që të vijnë në shkollë. Por nëse në shkollë shfaqet një sëmundje infektive ata nuk lejohet që të vijnë derisa të kalojë rreziku.**

Nëse fëmija juaj është i/e vaksinuar, ju lutemi që ta merrni me vete çertifikatën e vaksinimit kur të shkoni në shkollë për të regjistruar fëmijën tuaj.

Nënshkrimi ....................................................

Data .......................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Shkollat marrin fonde nga Ministria e Arsimit dhe e Zhvillimit të Hershëm Fëminor. Këto fonde përdoren për programet shkollore, por nga ana tjetër pridnërve u duhet që të blejnë ose të paguajnë shkollën për tekstet shkollore, kinkaleritë, ekskursionet, kampet, aktivitetet kulturore dhe materialet e programit mësimor për ato lëndë praktike ku nxënësit e mbajnë për vete projektin që kanë ndërtuar.

Këtë vit kontributi i prindërve për këto sende është $.........................

Përveç këtyre sendeve, këshilli i shkollës nganjëherë u kërkon prindërve që të japin kontribute në formë vullnetare si ndihmë me marrjen e fondeve për shkollën.

Këtë vit prindërve u kërkohet që të dhurojnë $............. Kjo pagesë bëhet sipas dëshirës.

Shkolla u jep prindërve mbështetje financiare. Nëse dëshironi të bisedoni në lidhje me mënyrat e pagesave, kontaktoni shkollën.
.

Nënshkrimi……………………………….

Data .....................................................

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Jemi të shqetësuar sepse ……………………………..… (student's name/emri i nxënësit) në Vitin ………..

nuk ishte në shkollë nga ………………………………………………..…………………………..
(day/s and date/s / dita dhe data)
deri ……………………………………………….......................…
(day/s and date/s / dita dhe data)

Ju lutemi na jepni arsyen e mungesës/ve në pjesën e mëposhtëme dhe kthejani atë shkollës sa më shpejt që të jetë e mundur.

Nëse djali/vajza juaj ka munguar në shkollë pa lejen tuaj, ju lutemi që të kontaktoni shkollën për të biseduar më tej.

Nënshkrimi………………………………………. Data……………………………………….

---

Ju lutemi PLOTËSOJENI, PREJENI DHE KTHEJENI këtë pjesë të formularit sa më shpejt që të mundeni.

Djali/Vajza ime ..........................................................................................nuk ishte në shkollë në
(student's name/Emri i Nxënësit)

........................................................................................................................................................................
(day/s and date/s / dita dhe data)

për arsyet e mëposhtme:

❒ sëmundje ❒ takim me mjekun ❒ takim me dentistin

❒ çështje familjare ❒ mungesë **pa** lejen time

❒ arsye tjetër (jepni detaje) .........................................................................................

Nënshkrimi ............................................... Data………………………………………….
(Parent/Guardian/Prindi/Kujdestari)

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

Të Dashur Prindër/Kujdestarë,

Programi shkollor i notit do të mbahet në (vendi)................................................................... ….

………………………………………………………………………………………(address/adresa)

në.........................................................................................në...................................................

(dates/datat) (times/orari)

Programi shkollor i notit është për të gjithë nxënësit.

Nxënësit do të shoqërohen dhe mbikqyren nga mësuesit e tyre dhe do të mësojnë not në grupe të vogla nga mësuesi i notit.

Ju lutemi që t'a informoni mësuesin në rast se ka ndryshime në rrethanat tuaja, p.sh. sëmundje.

Nxënësit duhet të marrin me vete:

☐ rrobat e banjës ☐ peshqir

☐ skufje (me dëshirë) ☐ syze (me dëshirë)

☐ rroba të rehatshme p.sh.tuta

Programi i notit kushton $..................................... për mësim. (Kosto Totale $ ............. )

..............................................................................Nënshkrimi

---

Ju lutemi PLOTËSOJENI, PREJENI DHE KTHEJENI këtë pjesë të formularit përpara datës

.......................................................................................................................................

(date/data)

Unë jap/nuk jap leje që________________________________________, Viti ................ ,

(student's name/emri i nxënësit)

të marrë pjesë në programin shkollor të notit.

☐ dëshiroj të paguaj $ për mësim.

OSE

☐ dëshiroj që të paguaj për të gjithë programin. Po bashkangjit $

Ju lutemi që të kontakoni shkollën në rast se dëshironi që të bisedoni në lidhje me mënyrat e tjera të pagesës.

Nënshkrimi ...................................................

(Parent/Guardian / Prindi/Kujdestari)

Data ……………………….

(School letterhead/logo)

(Date/Data)

I/E Dashur ………………………………………..,

Ju ftojmë në:

❒ një takim për të diskutuar në lidhje me raportin e shkollës për fëmijën tuaj

❒ një takim për të diskutuar në lidhje me përparimin e fëmijës suaj në shkollë

❒ një takim në lidhje me mungesat e fëmijës suaj në shkollë

Ju lutemi që të vini në shkollë në____________________ në ______________

për të takuar__________________________________________________________.

Për këtë takim mund të merret përkthyes sipas nevojës.

Shpresojmë se mund të vini. Ju lutemi që të njoftoni shkollën në ...............nëse nuk vini dot në këtë orë dhe dëshironi që të caktoni një takim tjetër.

Nënshkrimi……………………………..

Data………………………………..

---

Ju lutemi PLOTËSOJENI, PREJENI DHE KTHEJENI këtë pjesë të formularit përpara datës ......................................................................................................................................

(date/data)

Unë, ………………….. kam/nuk kam mundësi që të marr pjesë në takim. Emri i fëmijës tim është ………………………

Do të kem nevojë për përkthyes **nëse është e mundur** ❒ Nuk ka nevojë për përkthyes ❒

Kam nevojë për përkthyes në gjuhën………………………………

Nënshkrimi .................................................

Data .........................................

Nxënësit duhet të sjellin me vete në kamp sendet mëposhtme të shënuara me ✓.
Të gjitha sendet duhet të shënohen me emrin e nxënësit.

**1. PËR FJETJE**

☐ batanije ☐ çantë për fjetje ☐ pandofla

☐ jastëk i vogël ☐ pizhame ☐ dyshek me ajër

☐ dyshek

**2. VESHJE GJATË DITËS**

☐ xhinse/pantallona të gjata ☐ kapele ☐ kapuç

☐ pantallona të shkurtra ☐ shall ☐ kapele për shi

☐ këmishë ☐ çorape ☐ doreza

☐ të brendshme ☐ bluzë të trashë ☐ bluzë leshi

☐ këmishë e trashë me mëngë të gjata ose termale ☐ të brendshme termale

☐ pardesy ☐ atlete ☐ çizme

☐ këpucë për ecje ☐ sandale ☐ pandofla

☐ rroba banjo

**3. SENDE PERSONALE**

☐ peshqir ☐ krem plazhi ☐ krëhër

☐ spërkatës për insekte ☐ kartopiceta ose shami

☐ shampo ☐ sapun ☐ shishe uji

☐ mjetet personale mjekësore

**4. PËR TË NGRËNË**

☐ pjatë ☐ tas ☐ filxhan

☐ thikë/pirun/lugë ☐ peshqir

**5. TË TJERA**

☐ fletore/bllok shënimesh ☐ laps dhe stilolaps ☐ aparat fotografik

☐ çantë plastike për rrobat e palara ☐ elektrik dore dhe bateri

☐ zarf me adresë dhe pullë

6. **PARA PËR SHPENZIME**: Jo më shumë se $.........